



Moneta është institucion financiar jo-bankar, i specializuar në ofrimin e shërbimeve financiare, me një personel me përvojë shumëvjeçare në këtë fushë. Me qëllim të avancimit të veprimtarisë, Moneta tani është duke kërkuar kandidat të kualifikuar dhe profesional, për pozitën:

Shef/e Kontabiliteti

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë:

- Përgatit pasqyrat financiare mujore dhe raporte të ndryshme duke mbledhur dhe analizuar informatat e kontabilitetit;
- Bën, kontrollon dhe monitoron regjistrimet dhe kalkulimet e provizioneve për agjentë;
- Ndihmon në përgatitjen e buxhetit të Korporatës dhe bën përcjelljen e realizimit të tij;
- Përgjegjës për librin kryesor si dhe procedimin dhe raportimin për asetet fikse;
- Përgjegjës për monitorimin e përhershëm të llogarive bankare të Korporatës dhe rikonsilimin në rast të mospërputhjeve;
- Përgjegjës për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën me kohë të të gjitha llojeve të tatimeve, kontributeve dhe taksave të tjera;
- Bashkëpunon me inspektorët e ATK-së gjatë vizitës ose kryerjes së kontrolleve në Korporatë;
- Përgatit pasqyrat financiare vjetore dhe bashkëpunon me auditorët e jashtëm gjatë kryerjes së auditimit;
- Përgatit raportet periodike për BQK sipas kërkesave ligjore;
- Kryen analiza financiare dhe të profitabilitetit sipas kërkesës së menaxhmentit.

Kualifikimet dhe shkathtësitë profesionale:

- Diplomë universitare në ekonomi apo në fusha të ngjashme;
- Preferohet kualifikimi pasuniversitar;
- Të jetë i/e çertifikuar nga SCAAK në nivelin e kontabilistit;
- Preferohet të ketë njohuri të Quickbooks;
- Shkathtësi të shkëlqyera numerike dhe analitike;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi në gjuhën shqipe dhe angleze;

Të gjithë të interesuarit duhet të aplikojnë përmes sistemit elektronik të rekrutimit në www.monetaks.com apo të dërgoni email në hr@monetaks.com. Së bashku me Aplikacionin apo email-in, ju lutem bashkëngjitni CV-në tuaj.

Afati për aplikim do të jetë deri më datën **29 janar 2021**. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Aplikimet e pakompletuara dhe të dërguara me vonesë, nuk do të merren parasysh.

Aplikoni këtu: <http://www.monetaks.com/?p=934>



MoneyGram
transferim parash

MONETA • Illyria building • Prishtina – Graçanica highway • Veternik • Prishtina 10060 • Republic of Kosovo
MONETA • Ndërtesa Illyria • Rruga Prishtinë – Graçanicë • Veternik • Prishtinë 10060 • Republika e Kosovës
Tel: +381 38 602 102 • +377 45 602 102 • +386 49 602 102

www.monetaks.com